



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



RAPORT PËR VLERËSIMIN E GJENDJES SË REZISTENSËS NDAJ KORRUPSIONIT ZGJEDHOR TE POPULLATA STUDENTORE



RAPORT PËR VLERËSIMIN E GJENDJES SË REZISTENSËS NDAJ KORRUPSIONITZGJEDHOR TE POPULLATA STUDENTORE



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim – IHSE

Për botuesin: Dr. Misho Dokmanoviq

Autor: Dr. Darko Spasevski

Përkthyes: Urim kadriji

Shtypi: Stobi Trejd DOOEL Kočani

Raporti është përgatitur nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim – IHSE me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe në partneritet me MCMS. Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e MCMS, USAID-it apo Qeverisë së SHBA-së.

HYRJJE



Lufta kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (MK) është sfidë e theksuar për një periudhë të gjatë kohore. Hulumtimi i Transparency International për vitin 2023 e renditi Maqedoninë e Veriut në vendin e 76-të nga gjithsej 180 vende (vendet e renditura në botë).¹ Pozicioni i pafavorshëm në luftën kundër korrupsionit është theksuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2023 (Raporti i Maqedonisë së Veriut 2023²), ku vihet re gatishmëri e ulët në këtë segment të luftës kundër korrupsionit, duke theksuar mungesën e ndonjë progresi krahasuar me atë të vitit të mëparshëm.

¹ Rënditja është në dispozicion në lidhjen <https://www.transparency.org/en/countries/north-macedonia>

Sondazhi i fundit i IHSA i publikuar në qershor të vitit 2023, tregoi se deri në 20% e studentëve të anketuar në MK besojnë se korrupsioni është jashtëzakonisht ose shumë i përhapur³. Sipas hulumtimit të Transparency International, korrupsioni zgjedhor është një nga

² „Raporti i Maqedonisë së Veriut 2023”, Komisioni Evropian, në dispozicion në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf.

³ Rozarta Add, Milos Hrnjaz, Ivana Shumanovska Spasovska „Studim mbi perceptimin e korrupsionit në arsimin e lartë në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi”, ISIE, <https://corruptionfreeuni.com/wp-content/uploads/2024/01/ISIE-Studim-mbi-Korrupsion-Parandalimin-MK.pdf>.



faktorët kyç që mund të ndikojë në integritetin e zgjedhjeve⁴. Gjithashtu, në këtë drejtim, UNODC South Eastern Europe on Corruption thekson qartë se korrupsioni zgjedhor paraqet minim të demokracisë, i cili gjithashtu mund të çojë në destabilizim politik.

Duke marrë parasysh se zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale janë mbajtur gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti (2024), vlen të theksohet se në Raportin paraprak (20 mars - 4 prill 2024) të Zyrës së OSBE-së - Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, nuk janë vërejtur modalitete të presionit dhe korrupsionit zgjedhor që synon studentët.

⁴ „Hyrje në korrupsionin zgjedhor“, Transparency International, e disponueshme në <https://knowledgehub.transparency.org/guide/topic-guide-on-electoral-corruption/5189>.

⁵ “UNODC Evropa Juglindore mbi Korrupsionin”, UNDOC, në dispozicion në <https://www.unodc.org/southeasterneurope/en/Corruption.html>.

Për të identifikuar dobësitë e mundshme për korrupsionin zgjedhor që synon studentët, duhet të merren parasysh tendencat e përgjithshme të arsimit të lartë në vend. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vitin akademik 2023/2024, në të gjitha vitet e studimit janë regjistruar gjithsej 52.316 studentë. Numri më i madh i studentëve, 40,695 studentë që përfaqësojnë 77,9%, janë regjistruar në institucionet e arsimit të lartë shtetëror, ndërsa 22,1% janë regjistruar në institucionet e arsimit të lartë privat. Të analizuara veçmas, në universitetet publike janë regjistruar shifrat e mëposhtme:

⁶ <https://www.osce.org/files/f/documents/5/3/566407.pdf>

⁷ https://www.stat.gov.mk/pdf/2024/2.1.24.27_mk.pdf



- Në Universitetin „Shën. Kirili dhe Metodi” – Shkup janë të regjistruar gjithsej 20.892 nxënës;
- Në Universitetin „Shën.Kliment Ohridski” - Manastir, janë regjistruar 3.114 nxënës;
- Në Universitetin „Goce Dellçev” - Shtip janë të regjistruar 6.385 studentë;
- Në Universitetin e Shkencave dhe Teknologjive të Informacionit „Shën Apostull Pavle” – Ohër, janë regjistruar 314 nxënës;
- - Në Universitetin e Tetovës janë të regjistruar 7785 studentë dhe
- Në Universitetin „Nënë Tereza” janë të regjistruar 1833 studentë.

Gjithsej 11298 studentë janë të regjistruar në të gjitha institucionet e arsimit të lartë privat në të gjitha vitet e studimit në vitin akademik 2023/2024.

Në praktikë vihet re mungesa e raporteve dhe analizave më të detajuara për ekspozimin e studentëve ndaj korrupsionit zgjedhor, i cili mund të shprehet nëpërmjet ushtrimit të së drejtës për strehim të organizuar të studentëve në konviktet shtetërore, ushtrimit të së drejtës së studentëve për bursat e studentëve, e drejta e punës studentore dhe praktika studentore, e drejta e organizimit studentor, privilegjet në kuadër të procesit të arsimit të lartë etj. Prandaj, ky Raport synon të analizojë situatën në këto segmente, veçanërisht në lidhje me pozitën e institucioneve kompetente dhe rolin e tyre, i cili përcaktohet në përputhje me kompetencat e tyre nga rregullimi material përkatës, duke marrë parasysh pikat e rëndësishme të ekspozimit të studentëve të korrupsionit zgjedhor. Gjithashtu, duke pasur parasysh se



projekti ka filluar të realizohet në kohën e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024, gjatë përgatitjes së këtij Raporti janë përfshirë edhe programet zgjedhore të partive politike.

Gjatë përgatitjes së këtij Raporti është realizuar dhe anketë në periudhën qershor - korrik 2024, në formë elektronike dhe të printuar, të cilës i janë përgjigjur gjithsej 218 të anketuar. Format i anketës është përshtatur me afatin e shkurtër kohor të zbatimit të projektit dhe përgjigjet e marra janë të natyrës indikative.

Duke marrë parasysh se ky Raport i paraprin publikimit të projektit të radhës „Udhëzues për mbrojtjen e popullatës studentore nga korrupsioni zgjedhor”, procedurat e veçanta për mbrojtjen e të drejtave të studentëve para institucioneve përkatëse janë përfshirë në Udhëzuesin. Për këto arsye, Raporti dhe Udhëzuesi duhen të trajtohen si dy botime plotësuese.

Ky Raport është përgatitur në kuadër të projektit „Veprimi për parandalimin e korrupsionit zgjedhor ndaj studentëve” i cili zbatohet në kuadër të programit „Qytetarët kundër korrupsionit” (QKK) financuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID.

Ushtrimi i të drejtave në rast të ekspozimit ndaj korrupsionit zgjedhor në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve


Ligji për mbrojtjen e denoncuesve⁸ (në tekstin e mëtejshëm: LMD) në përgjithësi trajton dhe mundëson raportimin e korrupsionit, gjegjësisht sjellje ndëshkuese, joetike ose të tjera të paligjshme ose të palejueshme⁹. Nisur nga vendosja e tillë në sistem të kësaj dispozite, mund të reflektohet dobia dhe roli i saj në ushtrimin e mbrojtjes së studentëve të ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor.

Në mënyrë që studenti të paraqitet si denoncues në përputhje me këtë ligj, është e nevojshme që studenti të identifikohet ose të jetë nën përcaktimin dhe kriteret për

denoncues të përcaktuar në nenin 2, pika 2 dhe 3 të LMD. Denoncues në kuptimin e LMD është personi nga kategoritë e përcaktuara në paragrafin (3) të ligjit. Gjegjësisht, kategoritë e personave të cilët në pajtim me këtë ligj mund të paraqiten në cilësi të denoncuesve janë: 1) personi i cili ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar ose të caktuar në institucionin respektivisht personin juridik për ku denoncon; 2) kandidati për punësim, kandidat për vullnetar ose praktikant në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon; 3) personi i cili është ose do ka qenë vullnetar ose praktikant në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon; 4) personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë i angazhuar për realizimin e

⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196/15 dhe 35/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/20.

⁹ Neni 2 (1) i PPE.



punës nga institucioni respektivisht personi juridik për ku denoncon; 5)personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë në marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër në bashkëpunim me institucionin respektivisht personin juridik për ku denoncon; 6)personi i cili shfrytëzon ose ka shfrytëzuar shërbime në institucionin respektivisht personin juridik në sektorin publik dhe privat për ku denoncon. Si denoncues mund të paraqitet çdo student që në bazë të dispozitës së përmendur ka krijuar marrëdhënie juridike me institucionin.

Në paragrafin 4 të nenit 2 të LMD janë të rregulluara dhe të përcaktuara institucionet që mund të jenë lëndë e denoncimit, edhe atë: organ i pushtetit shtetëror dhe lokal, organ tjetër shtetëror i themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, agjenci, fond, institucion publik ose ndërmarrje publike e themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe institucion tjetër i regjistruar si person

juridik¹⁰ me pronësi dominuese ose të plotë të shtetit. Në këtë kuptim, të gjitha institucionet e lidhura dhe pjesëmarrësit në procesin e arsimit të lartë, siç janë institucionet e arsimit të lartë, konviktet e studentëve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mund të jenë institucione që mund të marrin dhe të veprojnë sipas denoncimit të studentit që është i ekspozuar ndaj korrupsioni zgjedhor.

Neni 3 i LMD parashikon tre lloje të denoncimit të mbrojtur, përkatësisht:

- 1) denoncimi i brendshëm i mbrojtur i kryer në institucion, gjegjësisht personin juridik, për të cilin ka dyshime ose dijeni se është kryer, kryhet ose do të kryhet një veprë ndëshkuese, ose veprim tjetër i kundërligjshëm ose i palejueshëm

¹⁰ Me nocionin person juridik në kuptim të këtij ligji, nënkuptohet person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar ose regjistrin e personave të tjerë juridik të cilin e mban Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili nuk është mbuluar në nocionin institucioni në paragrafin (4) neni 2 të LMD.




që dëmton ose kërcënon interesin publik,

- 2) denoncimi i jashtëm i mbrojtur, i cili bëhet me denoncim në numër të caktuar të institucioneve, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike kompetente, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë apo institucionet të tjera kompetente,¹¹ gjegjësisht personat juridikë, ose
- 3) denoncimi publik i mbrojtur, i cili kryhet duke vënë në dispozicion informacionin publik (kryesisht përmes medias) në situata kur

¹¹ Denoncimi i jashtëm i mbrojtur kryhet në situatat kur: denoncimi i brendshëm i shtë i orientuar drejtpërdrejt apo tërthorazi kundër personit udhëheqës në institucion respektivisht person juridik ku denoncon ose denoncuesi nuk merr informacione në kohë për denoncimin e tij të brendshëm të mbrojtur që ai ka bërë paraprakisht dhe brenda afatit të përcaktuar me ligj, ose nuk janë marrë masa ose denoncuesi nuk është i kënaqur me veprimin ose dyshon se nuk do të merren masa ose se denoncimi i brendshëm i mbrojtur do të shkaktojë pasoja të dëmshme për të ose për personin e tij të afërt.

nuk mund të dorëzohet denoncimi përmes denoncimit të mbrojtur të brendshëm ose të jashtëm ose në thelb institucionet nuk kanë vepruar në kohën e duhur ose në mënyrë të papërshtatshme sipas mendimit të denoncuesit.

Denoncimi mund të jetë gjithashtu anonim. Neni 8 i LMD parashikon mbrojtjen nga çfarëdo lloji të shkeljes së të drejtës gjatë përcaktimit të përgjegjësisë, sanksion, ndërprerje e marrëdhënies së punës, suspendim i vendit të punës, sistemim në vend pune tjetër që është më pak i volitshëm, diskriminim ose veprimit të dëmshëm ose rrezikut nga paraqitja e veprimeve të dëmshme për shkak të kryerjes së denoncimit të mbrojtur të jashtëm dhe të brendshëm ose denoncimit të mbrojtur publik. Gjithashtu, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, denoncuesi ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore.



Vendosja e institucioneve të arsimit të lartë në ekspozimin e studentëve ndaj korrupsionit zgjedhor

Baza e kornizës ligjore me të cilën rregullohet arsimi i lartë është Ligji për arsimin e lartë (në tekstin e mëtejshëm: LAL).¹² Rëndësi të veçantë për këtë analizë ka LAL, duke rregulluar në detaje dhe nga të gjitha aspektet procesin e arsimit të lartë. Kjo rezulton nga fakti se një pjesë e madhe e të drejtave të studentëve janë të rregulluara me këtë ligj.


Ky ligj nis nga autonomia e garantuar me Kushtetutë e universiteteve dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, që nënkupton lirinë akademike, vendimmarrjen dhe menaxhimin e pavarur dhe paprekshmërinë e

hapësirës universitare.¹³ Në bazë të nenit 3 paragrafit 1 të Ligjit, veprimtaria e arsimit të lartë është me interes publik dhe ka rëndësi të veçantë për Republikën e Maqedonisë si pjesë e hapësirës ndërkombëtare dhe të hapësirës së vetme evropiane arsimore, shkencore dhe artistike. Ligji në nenin 13 paragrafin 2 përfshin ndalimin e organizimit partiak dhe veprimin, si dhe shfaqjen e shenjave partiake në institucionet e arsimit.

Për të drejtat dhe detyrimet e studentëve, ata e gjejnë bazën e tyre në nenin 27 të LAL, i cili rregullon pikërisht këtë çështje. Në kuadër të kësaj analize, për situatat kur lehtësitë (privilegjet) e mundshme financiare mund të përdoren për të shërbyer për korrupsionin zgjedhor, mund të theksohet paragrafi (6) i nenit 27 të

¹² „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/21 dhe 58/24.

¹³ Neni 2 (1) i LAL.



Ligjit. Përkatësisht në përputhje me këtë dispozitë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të marrë vendim për volitshmëri të posaçme për studentët, siç janë kartela studentore për lirime, transport urban falas dhe të tjera, me ç' rast mjetet sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Të drejtat dhe interesat e studentëve përfaqësohen dhe ndihmohen në realizimin e tyre nga organizatat studentore dhe avokati i studentëve. Në bazë të nenit 31 paragrafi 1 të LAL, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të studentëve në secilin universitet zgjidhet avokati i studentëve, nga radhët e studentëve të rregullt në universitet. Përveç Avokatit të

Studentëve në nivel Universiteti, zgjidhet edhe një zëvendës avokat i studentëve në nivel njësie (fakulteti). Prandaj, në përputhje me nenin 31 paragrafi 3 të ligjit, në çdo njësi të Universitetit, zgjidhet zëvendës avokat i studentëve, të cilin e zgjedh kuvendi i studentëve të fakultetit me konkurs të shpallur më parë nga radhët e studentëve të rregullt. Kompetencat e avokatit të studentëve janë të rregulluara në nenin 32 të ligjit.

Në bazë të ligjit, (neni 33 paragrafi 1), kuvendet e studentëve janë trupa të institucioneve të arsimit të lartë, në të cilat të anëtarësuar janë përfaqësues të studentëve. Institucionet e arsimit të lartë janë të detyruara që kuvendeve të studentëve, avokatit të

³ Член 31 од ЗСКСИ.



studentëve dhe zëvendës avokatit të studentëve t'u sigurojnë hapësira për punë dhe t'u ofrojnë ndihmë teknike administrative. Institucionet e arsimit të lartë janë të obliguar, sipas mundësive të tyre, t'i mbështesin kuvendet e studentëve që janë të organizuar në suaza të tyre.

Neni 34 i LAL rregullon financimin e kuvendeve të studentëve, nga mjetet e institucionit të arsimit të lartë, si dhe nga: legatet, dhuratat, testamentet, kontributet dhe burime tjera., ku institucionet e arsimit të lartë janë të obliguara t'u mundësojnë kuvendeve të studentëve disponim autonom me mjetet për punën e tyre në pajtim me këtë ligj dhe me aktet e përgjithshme

të institucioneve të arsimit të lartë. Në këtë kuptim, kjo situatë, si çdo situatë e ngjashme ku ka burime financiare, mund të përmbajë një shkallë të caktuar rreziku për përdorimin e mundshëm të burimeve financiare, për korrupsionin zgjedhor.

Kompetencat e kuvendit studentor të universitetit janë të rregulluara në nenin 36, ndërsa kompetencat e kuvendit studentor të fakultetit janë të rregulluara në nenin 37 të ligjit.

Në bazë të nenit 39 të ligjit, studentët marrin pjesë në administrimin me institucionet e arsimit të lartë nëpërmjet përfaqësuesve të cilët i zgjedhin në: 1) kuvendin studentor universitar, kuvendin studentor të





fakultetit dhe kuvendin studentor të shkollës së lartë profesionale; 2) në organet e institucioneve të arsimit të lartë; 3) nëpërmjet formave të vetorganizimit ose në mënyrë tjetër sipas kushteve të caktuara me ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Lidhur me raportimin e korrupsionit dhe mekanizmat për raportimin e korrupsionit, përveç serisë së mekanizmave ekzistues për raportimin e korrupsionit që përdoren në Republikën e Maqedonisë së

Veriut, Ligji për arsimin e lartë në nenin 107 parasheh caktimin e personit të autorizuar të posaçëm për pranimin e denoncimeve për korrupsion. Konkretisht, në përputhje me këtë dispozitë, me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes më efektive nga korrupsioni, Senati i universitetit zgjedh një person të autorizuar nga profesorët e rregullt të universitetit për pranimin e denoncimeve për korrupsion.




Ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor në përputhje me Kodin zgjedhor

Kodi Zgjedhor¹⁴ rregullohen mënyra, kushtet dhe procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: kryetari i Republikës), për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: deputetët), për anëtarët e këshillave të komunave gjegjësisht Këshillit të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: anëtarët e këshillave), për zgjedhjen e kryetarit të komunave gjegjësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: kryetari i komunës), mënyra dhe procedura e

evidentimit të së drejtës zgjedhore, mbajtja e Listës zgjedhore, përcaktimi i kufijve të njësive zgjedhore dhe përcaktimi, ndryshimi dhe shpallja e vendeve zgjedhore, si dhe kushtet për funksionimin e vendeve zgjedhore.

Kodi zgjedhor në nenin 2 paragrafi (1) pika 2) përmban përkufizimin e termit „proces zgjedhor“, i cili përkufizohet si proces që zgjat nga miratimi i aktit për shpalljen e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të mbajtura, në nivel komune, qyteti i Shkupit, përkatësisht njësia zgjedhore ku mbahen zgjedhjet.

¹⁴ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/ 15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24 dhe 76/24.



Dispozitat kryesore që lidhen me parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve zgjedhore në procesin zgjedhor janë dispozitat e neneve 8-a, 8-b dhe 8-c të Kodit Zgjedhor. Pra, në nenin 8-a 1) parashikohen një sërë kufizimesh në lidhje me disponimin dhe përdorimin e fondeve nga buxheti në procesin zgjedhor. Përkatësisht, në përputhje me këtë dispozitë, nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, respektivisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit nuk- të fillojë

ndërtimi me mjete nga buxheti ose nga fonde publike ose mjete të ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror të objekteve të reja të infrastrukturës si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive dhe objekte tjera; ose objekte për veprimtari shoqërore, shkolla, çerdhe dhe objekte tjera, përveç nëse për këtë qëllim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, respektivisht bëhet fjalë për realizimin e programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin vijues dhe:

- të kryhen pagesa të rrogave, pensione, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime materiale nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike që nuk janë mjete pagesore të rregullta mujore, respektivisht të gjitha transferet njëvjeçare dhe pagesa të transfereve të njëhershme nga



mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike, as të tjetërsohet kapitali shtetëror ose të nënshkruhen marrëveshje kolektive. mund:

- të fillohet procedurë për punësimin e personave të rinj apo procedurë për pushimin e marrëdhënies së punës në institucione shtetërore dhe publike, kurse procedurat e filluara vihen në pezullim, përveç në rastet e punëve urgjente dhe të paprolongueshme.

Si kufizim i veçantë është dispozita e nenit 8a (2), i cili përcakton periudhën prej 20 ditësh para fillimit të fushatës zgjedhore deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në

përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, respektivisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit nuk mund:

- të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose fonde publike, ose me mjetet e ndërmarrjeve publike ose personave tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror, në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive ose objekte për veprimtari shoqërore, çerdhe si dhe objekte të tjera. Me ndalim të mbajtjes së ngjarjeve publike nuk nënkuptohet, veçanërisht: dhënia e deklaratës publike e bartësit të funksionit publik ose kandidatit për bartës të funksionit publik në miting, intervistë në medie, debat në medie ose përgjigje të pyetjes së gazetarëve.





Obligim i veçantë për shpalljen publike të pagesave buxhetore përveç shpenzimeve të rregullta rrjedhëse (paga, pensione dhe shpenzime komunale) në faqet e internetit të Ministrisë së Financave është paraparë në nenin 8-a (3) të Kodit Zgjedhor.

Më tej, neni 8-b i Kodit Zgjedhor përmban ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime dhe nevoja të fushatës zgjedhore. Pra, në përputhje me nenin 8-b (1) të Kodit Zgjedhor, për qëllime të fushatës zgjedhore, ndalohet Për nevojat e fushatës zgjedhore, ndalohet shfrytëzimi i hapësirës së zyrës, pajisjes së zyrës dhe automjetet zyrtare të organeve shtetërore, përveç personave me të cilat kanë të bëjnë rregullat e veçanta për mbrojtjen e personalitetit. Gjithashtu, paragrafi (2) i këtij neni parashikon që në afat prej dhjetë ditësh nga

miratimi i vendimit për shpalljen e zgjedhjeve për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetar komune ose anëtarë të këshillave, fondet publike, ndërmarrjet publike dhe të gjithë personat e tjerë juridikë që menaxhojnë kapital shtetëror, kanë për detyrë në Komisionin Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit të dërgojnë të dhëna për numrin, llojin, targat e regjistrimit dhe gjendjen e automjeteve të cilat i kanë në dispozicion.

Në përgjithësi, si klauzolë parandaluese është dispozita nga neni 8-v i Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, partitë politike pjesëmarrëse në procesin zgjedhor, nënshkruajnë Kodeks për zgjedhje të lira dhe demokratike. Me Kodeksin nga pjesëmarrësit në procesin



zgjedhor padyshim obligohen se nuk do të bëjnë kurrfarë presioni apo përpjekje për presion mbi të punësuarit në administratën publike dhe shtetërore, në institucionet tjera të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe Qyteti i Shkupit, si dhe në shoqëritë dhe ndërmarrjet tregtare me kapital shtetëror. Gjithashtu, me Kodeksin pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, gjithashtu, padyshim obligohen se asnjë person i punësuar apo qytetar nuk do të jetë lëndë e çfarëdo kërcënimi në lidhje me punësimin e tij dhe sigurinë sociale si rezultat të mbështetjes së tyre apo mos mbështetjes së tyre të cilësdo parti politike apo kandidati.

Nga pikëpamja procedurale duhet theksuar nenin 12 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, aktin për shpalljen e zgjedhjeve e merr kryetari i Kuvendit dhe me të caktohet dita kur fillojnë të rrjedhin afatet për zbatimin e veprimeve zgjedhore dhe dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 17 i Kodit Zgjedhor përcakton organet për kryerjen e zgjedhjeve, përkatësisht: 1) - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve; 2) komisionet komunale të zgjedhjeve gjegjësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit; 3) këshillat zgjedhorë dhe 4) Këshillat zgjedhorë për votim në përfaqësitë diplomatike-konsullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: PDK) përkatësisht zyra konsullore. Kompetencat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve janë të rregulluara në nenin 31 të Kodit Zgjedhor. Sipas nenit 69-a të Kodit Zgjedhor, si fushatë zgjedhore llogaritet tubimi publik dhe ngjarje tjera publike të organizuara nga ana e pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, vendosja publike e pllakateve, video prezantime në vende publike, prezantim zgjedhor mediatik dhe në internet, shpërndarje të materialeve të shtypura dhe prezantim publik të kandidatëve të konfirmuar nga organe kompetente zgjedhore dhe programeve të tyre.



Neni 72 pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se për ligjshmërinë e zbatimit të fushatës zgjedhore. pjesëmarrës i përgjegjshëm në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore përgjigjet edhe për ato veprime të fushatës zgjedhore për të cilat autorizon persona të tjerë.

Kodi Zgjedhor rregullon edhe një procedurë të veçantë në nenin 74 për sanksionimin për mosveprim të nenit 74 gjegjësisht veprim në kundërshtim me nenet 8-a dhe 8-b të Kodit Zgjedhor., Në rast të kundërshtimit të parashtruar për mosrespektimin e dispozitës të neneve 8-a dhe 8-b të këtij Kodi, Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit obligohet në mbledhje publike t'i hulumtojë konstatimet dhe të veprojë për kundërshtimin e parashtruar në afat jo më të gjatë se pesë ditë nga dita e parashtrimit të kundërshtimit. Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit vendos për kundërshtimet në mbledhje publike dhe vendimet e tij në afat prej 24

orëve i publikon në ueb faqen e tij. Në mbledhje mund të jetë i pranishëm edhe parashtruesi i kundërshtimit dhe i njëjti ka të drejtë të prononcohet gojarisht.

Po ashtu, në të njëjtin nen 74 paragrafi 3 parashikohet se (3) kundër vendimit të Komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit nga paragrafi (2) i këtij neni parashtruesi i kundërshtimit ka të drejtë të padisë deri te Gjykata Administrative në afat prej 24 orëve nga pranimi i vendimit. Gjykata Administrative obligohet që të miratojë vendim në afat prej 48 orëve nga pranimi i padisë.



Parandalimi i korrupsionit në politikë në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave


Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (në tekstin e mëtejshëm: LPKKI)¹⁵ përmban kapitull të veçantë kapitullin katërt me titull „parandalimi i korrupsionit në politikë” i cili drejtpërsëdrejti synon aktet e paligjshme që lidhen me zgjedhjet, fushatat zgjedhore, financimin e partive politike dhe të ngjashme. Në nenin 2 të LPKKI, me korrupsion nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës apo pozitës zyrtare për realizim të dobisë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet


ndërmjetësuesit, për vete ose për tjetër person. Në të njëjtën kohë, kjo dispozitë (neni 2, paragrafi 2) i LPKKI bën dallimin ndërmjet korrupsionit pasiv¹⁶ dhe korrupsionit aktiv¹⁷. Për më tepër, në përputhje me paragrafin (3) të nenit 2 të LPKKI, me konflikt të interesave nënkuptohet gjendja në të

¹⁵ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 12/2019.

¹⁶ Korrupsioni pasiv - veprim i qëllimshëm i personit zyrtar, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi, kërkon ose pranon dobi në cilëndo formë, për vete ose për person të tretë, ose pranon premtim për dobi të këtyre, me qëllim të veprës ose të përmbahet prej veprimit në pajtim me obligimet e tij ose t'i ushtrojë kompetencat e tij në kundërshtim me obligimet zyrtare.

¹⁷ Korrupsioni aktiv – veprim i qëllimshëm i cilit do person i cili drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, premtim ose jep dobi në çfarëdo forme për person zyrtar, për vete ose person të tretë, me qëllim të veprës ose të përmbahet prej veprimit në pajtim me obligimet e tij në kundërshtim me obligimet zyrtare.





cilën personi zyrtar ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi kryerje të paanshme të autorizimeve të tij publike ose detyrave zyrtare..

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit) është i mëvetësishëm dhe i pavarur në kryerjen e punëve të caktuara me LPKKI dhe ka cilësi të personit juridik, dhe ka cilësi të personit juridik.¹⁸ dhe përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë¹⁹. Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për periudhë prej pesë vitesh, pa të drejtë rizgjedhjeje.²⁰

Kompetencat e përgjithshme të KSHPK-së janë të rregulluara në nenin 17 të LPKKI. Duke marrë parasysh karakterin dhe nevojat e këtij hulumtimi, ne do t'i përmbahemi kompetencave të KSHPK-së të parashikuara me këtë ligj, lidhur me zgjedhjet dhe procesin zgjedhor, të

cilat potencialisht do të shpreheshin me korrupsion zgjedhor, pavarësisht nëse korrupsioni është aktiv apo pasiv. Përveç LPKKI, KSHPK përcakton dhe drejton aktivitetet dhe veprimet e saj me strategjinë nacionale pesëvjeçare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave me plan veprimi për zbatimin e saj.²¹ Komisioni Shtetëror përgatit Strategjinë nacionale bazuar në analizën e përgatitur më parë ndaj rrezeve të korrupsionit. Strategjia nacionale i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim. Komisioni Shtetëror miraton metodologji për përgatitjen e strategjisë nacionale, para fillimit të procesit të përgatitjes së strategjisë nacionale. Në bazë të nenit 18 të LPKKI, strategjia nacionale përgatitet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore, institucioneve, shoqatave, fondacioneve, sektorit privat dhe medias.

¹⁸ Neni 9 (1) i LPKKI.

¹⁹ Neni 9 (2) i LPKKI.

²⁰ Neni 10 (1) i LPKKI.

²¹ Neni 18 i LPKKI.



Meqekardhje mund të konstatojmë se Strategjia nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021-2025²² përmban vetëm masa, synime dhe prioritetë të kufizuara që synojnë korrupsionin zgjedhor, ndërsa korrupsioni zgjedhor drejtuar studentëve nuk përmendet fare. Masat që përfshihen dhe detektohen janë renditur në rubrikën „Sistemi politik“. Në këtë segment theksohet: „...duhet të përcaktohen me saktësi rregullat në procesin (para)zgjedhor, financimin e fushatave politike përmes mediave online dhe sigurimin e mbrojtjes nga keqpërdorimi i procesit zgjedhor për punësimet e reja dhe manipulime të tjera.“ Gjithashtu, në rubrikën „Media dhe shoqëria civile“ vihet re si në vijim: „Për të përmirësuar situatën në sferën mediatike dhe për të parandaluar keqpërdorimet e mediave për qëllime politike, është e nevojshme të vendoset monitorim i përforcuar dhe të hiqet reklamimi politik me pagesë i partive në ciklet zgjedhore. Në këtë drejtim, Strategjia nacionale në sektorin 5.1 detekton

problemin konkret 6 i cili thotë: „Nuk ka asnjë mekanizëm apo autoritet për monitorim efektiv të përfaqësimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit“ që për zgjidhjen e kësaj situatë, Strategjia në këtë pjesë parasheh masën e mëposhtme „Tarifa për reklamim në portalet e internetit të jetë barrë e Buxhetit të RMV-së“.

Në LPKKI, disa dispozita janë të drejtpërdrejta relevante dhe kanë të bëjnë me paritë politike, gjegjësisht aktivitetet politike. Në thelb, bëhet fjalë për dispozitat e kapitullit të katërt të LPKKI me titull „Parandalimi i korrupsionit në politikë“. Bëhet fjalë për disa dispozita që përfshijnë:

- Ndjekjen e ligjshmërisë së financimit të partive politike (neni 31);
- Ndjekjen e ligjshmërisë së financimit të fushatave zgjedhore (neni 32);

²² <https://dksk.mk/mk/%D0%B-D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%B-D%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0-2020-2024-2/>




- Kontrollin për keqpërdorim të mjeteve buxhetore në periudhën pas shpalljes së zgjedhjeve (neni 33);
- Ndalimin për investime të reja dhe pagesa të jashtëzakonshme (neni 34);
- Ndalimin për shfrytëzimin e burimeve të kundërligjshme dhe anonime të financimit gjatë zgjedhjeve (neni 35);
- Dhënien rryshfet zgjedhësve (neni 37);
- Privilegjin ose diskriminim në furnizimet publike dhe marrëveshje tjera (neni 38) dhe
- Ndikimin gjatë zgjedhjes, emërimeve dhe shkarkimit të vende udhëheqëse (neni 39).


Pra, neni 31 i LPKKI, përcakton ndjekjen e ligjshmërisë së financimit të partive politike. Dispozita e paragrafit (1) të nenit 31 përcakton se në rast të ekzistimit të dyshimit për financim joligjor të partisë

politike. Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose me iniciativë nga organe shtetërore, parti politike ose shoqata dhe fondacione që punojnë në sferën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të së drejtës ose menaxhimit të mirë, mund të miratojë aktvendim për fillimin e procedurës për hulumtimin e financimit të partisë politike. Po ashtu, në të njëjtën dispozitë, saktësohen veprimet procedurale që mund të ndërmer KSHPK gjatë procedurës.

Neni 32 i LPKKI, i jep mandat KSHPK që të veprojë në rast të ekzistimit të dyshimit për financim joligjor të fushatës zgjedhore, Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose me kundërshtim nga organizatori i fushatës zgjedhore ose vëzhguesit e akredituar, ngre procedurë për përcaktimin e gjendjes faktike.

Në përputhje me nenin 33, KSHPK





është kompetent ta ndjekë ligjshmërinë e shfrytëzimit, përkatësisht disponimit me mjetet buxhetore nga dita e shpalljes deri në përfundimin e zgjedhjeve. Në rast të ekzistimit të dyshimit për shkelje të dispozitave nga Kodi Zgjedhor për ndalim të përdorimit të mjeteve buxhetore, përkatësisht veprime të ndaluara të institucioneve publike nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, si dhe shkelje të dispozitave të këtij ligji që rregullojnë veprim të ndaluar nga çasti i miratimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose pas kundërshtimit të parashtruar nga organizatori i fushatës zgjedhore, hap procedurë për konstatimin e gjendjes faktike. Në përputhje me dispozitën, si pasojë e përcaktimit të vlefshmërisë së dyshimeve, KSHPK është i detyruar që të iniciojë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë, deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të komunës ose të anëtarëve të këshillit respektivisht konstituimit të këshillit të komunave dhe të qytetit të Shkupit, në pajtim me nenin 34, janë paraparë disa kufizime për investime të reja dhe pagesa të jashtëzakonshme.



Ndalimi për shfrytëzimin e burimeve të kundërligjshme dhe anonime të financimit gjatë zgjedhjeve është i përcaktuar në nenin 35 të LPKKI, i cili gjithashtu përmban ndalimin sipas të cilit partia politike ose kandidati në zgjedhje nuk guxojnë të mbledhin dhe shfrytëzojnë mjete të kundërligjshme ose nga burime anonime. Nëse paraqitet dyshim se partia politike ose kandidati në zgjedhje ka përdorur mjete në mënyrë të paligjshme ose nga burime anonime, Komisioni Shtetëror do të kërkojë nga organet kompetente të kryejnë kontroll të burimit të mjeteve dhe të ai të dorëzojnë raport të hollësishëm për shfrytëzimin e mjeteve. Kontrollimi i hyrjes së mjeteve ose pagesa tjera përmes bankës, me kërkesë të Komisionit Shtetëror, nuk paraqet shkelje të sekretit bankar. Nëse konstatohen se dyshimet janë të bazuara, Komisioni Shtetëror në afat prej shtatë ditëve nga dita e përcaktimit të dyshimit të bazuar, inicion procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente..

Procedura për ryshfet ndaj zgjedhësve rregullohet në nenin 37 të LPKKI, i cili përcakton se nëse Komisioni Shtetëror kupton ose ka baza për dyshim për ryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, respektivisht për dhënien ose premtimin e dhuratës, ose ndonjë përfitim tjetër për vete ose për tjetër, zgjedhësit gjatë zgjedhjeve ose votimit në referendum, që të votojë ose të mos votojë, ose të votojë për kandidat të caktuar ose vendim të caktuar, për atë pa prolongim do ta njoftojë prokurorin publik kompetent. Në kapitullin e katërt të LPKKI, megjithëse nuk lidhet drejtpërdrejt me zgjedhjet, por ka të bëjë me politikën, kompetencat e KSHPK për të vepruar në rastin Privilegj ose diskriminim në furnizimet publike dhe marrëveshje tjera (neni 38 i LPKKI) si gjatë ndikimit të zgjedhjes, emërimeve dhe shkarkimit në vende udhëheqëse (neni 39 i LPKKI).

Përfitimet financiare të studentëve dhe trajtimi i tyre ligjor


Subvencionimi i shujtës studentore

Ligji për subvencionim të shujtës studentore (në tekstin e mëtejshëm: LSSH) është një dispozitë relativisht e re ligjore nga viti 2020, në të cilin rregullohen e drejta e studentëve për shujtë studentore të subvencionuar, si dhe mënyra dhe kriteret e subvencionimit. Me „shujtë e subvencionuar studentore” nënkuptojmë mbështetje financiare në shumë prej 140 denarë që studenti e merr nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për blerjen e ushqimit të përgatitur. Shuma e

shujtës së subvencionuar studentore harmonizohet në pajtim me shkallën e inflacionit pas çdo viti fiskal, ndërsa para miratimit të Buxhetit Republikan për vitin e ardhshëm;. Procedura për marrjen e subvencionuar të shujtës së studentëve është e rregulluar në nenin 3-c të LSSH. Konkretisht, procedura fillon me thirrje publike për përzgjedhjen e bartësit të transaksionit të pagesës, përmes së cilës paguhet mjetet financiare të studentëve, të cilën e zbaton Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

²³ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 31/20 dhe 150/21 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 91/23 dhe 30/24.

²⁴ Neni 2 (1) 1) i LSSH



Subvencionimi i shujtës studentore kryhet nga mjetet të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat përdoren vetëm për këtë qëllim. Shfrytëzuesit e shujtës së subvencionuar studentore janë

studentë të rregullt në studime deridiplomike në universitete shtetërore dhe private, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 9 të LSSH.

Akomodimi i organizuar studentor dhe bursat studentore

Ligji bazë që rregullon të drejtat financiare të studentëve të ofruara nga shteti është Ligji për standardin e studentëve²⁶ (në tekstin e mëtejshëm: LSS). Me këtë Ligj rregullohen veprimtaria e standardit të studentëve, themelimi, organizimi, funksionimi dhe menaxhimi në institucionet për standardin e studentëve si pjesë e sistemit të arsimit dhe dhënia e bursave studenteve.

Veprimtaria e standardit të studentëve që realizohet në konviktet

e studentëve është me interes publik.²⁷ Çdo student i rregullt, me kushte të barabarta të përcaktuara me këtë ligj, ka të drejtë të qëndrojë në konvikt të studentëve.²⁸

Në aspektin e veprimit politik dhe të veprimtarisë shoqërore, duhet theksuar se në përputhje me nenin 5 të LSS, në konviktin e studentëve është i ndaluar arsimiti fetar, si dhe organizimi dhe veprimi politik dhe religjioz, gjithashtu në hapësirat e konviktit të studentëve ndalohet paraqitja e simboleve partiake dhe fetare. Lidhur me organizimin e konvikteve shtetërore të studentëve,

²⁵ Neni 8 i LSSH

²⁶ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. Republika e Maqedonisë së Veriut" nr. 124/19 dhe 248/20 dhe 302/20.

²⁷ Neni 3 i LSS.

²⁸ Neni 4 i LSS.

në përputhje me nenin 10 paragrafi 1 i LSS, konvikti i studentëve është institucion i cili studentëve u siguron vendosje, ushqim, kujdes për shëndetin, aktivitete kulturore festive, rekreative sportive dhe të tjera. Ligji gjithashtu lejon të organizohet vendosje edhe në konvikt privat të studentëve.²⁹ Puna në konviktet e studentëve gjatë vitit studimor përcaktohet me program vjetor.³⁰

Të drejtë vendosjeje dhe ushqimi në konviktet shtetërore të studentëve kanë studentët që shkollohen jashtë vendbanimit të tyre.³¹ Regjistrimi dhe pranimi në konviktet shtetërore të studentëve kryhet përmes konkursit që e shpall Ministria për Arsim dhe Shkencë në mjetet e informimit publik më së voni deri më 15 korrik.³² Në nenin 24 të ligjit gjithashtu parashikohen edhe kushtet dhe kriteret e veçanta për pikëzimin e studentëve të regjistruar. MGjatë vlerësimit të kategorive të veçanta të nxënësve që përfitojnë mbrojtje të veçantë sociale, zbatohet edhe neni 25 i ligjit.

²⁹ Neni 10 (2) i LSS.

³⁰ Neni 23 i LSS.

³¹ Neni 24 (1) i LSS.

³² Neni 24 (2) i LSS.


Studentët e pranuar në konvikte rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre me një kontratë që lidhin me konviktet.³³ Sa i përket organizimit të konviktit të studentëve, duhet theksuar se organi drejtues në konviktin shtetëror të studentëve është këshilli drejtues.³⁴ Këshilli drejtues i konviktit shtetëror të studentëve përbëhet nga shtatë anëtarë, si vijon: tre përfaqësues nga themeluesi, dy nga radhët e të punësuarve në konviktin e studentëve, një përfaqësues nga radhët e studentëve, banorë në konvikt shtetëror të studentëve dhe një përfaqësues i universitetit ku konvikti i studentëve është anëtar shoqëruar, në bazë të parimeve të profesionalitetit dhe kompetencës. Drejtori është organ udhëheqës i konviktit të studentëve dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë dhe për punën materiale-financiare të konviktit të studentëve.³⁵

Mjetet për financim të konvikteve shtetërore të studentëve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin për buxhete,

³³ Neni 26 (2) i LSS.

³⁴ Neni 34 (1) i LSS.

³⁵ Neni 37 (1) i LSS.




Ligjin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, si dhe nga shfrytëzuesit e shërbimeve.³⁶ Konviktet e studentëve mund të marrin mjete edhe nga: participimi i shfrytëzuesve të shërbimeve, shitja e prodhimeve dhe shërbimeve që janë rezultat i veprimtarisë plotësuese dhe legate, donacione, testamente dhe burime tjera.³⁷

Një tjetër modalitet i orientimit financiar ndaj studentëve, i rregulluar me LSS , janë bursat e studentëve. Përkatësisht, në përputhje me nenin 48 të LSS Me qëllim të zbulimit, stimulimit dhe kultivimit të studentëve me prirje nga sfera të ndryshme të shkencës, teknikës, kulturës, artit dhe sportit, Ministria ndan bursa për studentë. Kriteret bazë janë të rregulluara me nenin 48 paragrafin 2 të ligjit. Procedura për ndarjen e bursave të studentëve

për studentë të cilët studiojnë në Republikën e Maqedonisë bëhet në bazë të konkursit që e shpall Ministria në përputhje me nenin 49 të Ligjit. Në pajtim me nenin 50 të LSS, Shfrytëzues të bursave të studentëve mund të jenë studentë të rregullt, shtetas të Republikës së Maqedonisë, nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret në pajtim me këtë ligj. Njëkohësisht, duhet theksuar se në përputhje me nenin 51 të LSS, Ministria mund t'u ndajë bursa shtetasve të huaj në pajtim me vendim të Qeverisë, nëse ndarja e bursës është me interes për Republikën.

³⁶ Neni 45 i LSS.

³⁷ Neni 47 i LSS.



Kompetencat e inspektimit arsimor kur nxënësit ekspozohen ndaj akteve të korrupsionit zgjedhor

Për sa i përket trajtimit dhe mbikëqyrjes, rol të veçantë ka edhe inspektimi arsimor. Në këtë kuptim, inspektimi ka rol dhe rëndësi të veçantë në mbrojtjen e nxënësve dhe ushtrimin e të drejtave të tyre. Kjo sigurisht duhet të reflektohet edhe në lidhje me aspektet e ndryshme të ekspozimit të studentëve ndaj korrupsionit zgjedhor. Në bazë të nenit 2 paragrafit 3 të Ligjit për Inspeksionin Arsimor (në tekstin e mëtejshëm: LIA), në institucionet e arsimit të lartë dhe shkencor, mbikëqyrja inspektuese kryhet mbi zbatimin e ligjeve që rregullojnë arsimin e lartë dhe veprimtarinë shkencore, për çështjet e përcaktuara nga LIA. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme për përcaktimin e arsimit të lartë, si dhe për autonominë e institucioneve të arsimit të lartë në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë. Gjithashtu, mbikëqyrja inspektuese kryhet edhe mbi zbatimin e ligjeve, dispozitave dhe akteve të tjera që rregullojnë konviktet e studentëve.

Në procedurë gjatë mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për inspeksionin arsimor, ndërsa Ligji për mbikëqyrjen inspektuese dhe Ligji për procedurën e përgjithshme administrative zbatohen edhe për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj.

Për nga struktura organizative, Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka kapacitetin e personit juridik, llogarinë e tij buxhetore si përdorues buxhetor i linjës së parë, zbaton në mënyrë të pavarur procedurat e punësimit në përputhje me ligjin dhe vendos për të drejtat dhe detyrimet e punësimit.

Në bazë të nenit 19 të LIA, Inspektori shtetëror i arsimit kryen mbikëqyrjen nëpërmjet: 1) evoluimit integral të institucioneve edukativo-arsimore, 2) mbikëqyrjes së rregullt inspektuese, 3) mbikëqyrjes së jashtëzakonshme dhe 4) mbikëqyrjes kontrolluese. Kompetenca specifike e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit si dhe masat që mund të marrë rregullohen në nenin 29 të ligjit.

³⁸ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/05, 81/08, 148/09, 57/10, 51/11, 24/13, 137/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15, 30/16 dhe 64/ 18.

³⁹ Neni 3.

Trajtimi i komoditeteve dhe privilegjeve për studentët në programet zgjedhore të partive politike nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2024

Për qëllime të kësaj analize janë analizuar programet e gjashtë partive politike dhe koalicioneve që kanë marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 dhe programet e të cilave janë në dispozicion të publikut. Në analizë janë të përfshira programet e VMRO DPMNE dhe koalicionit, LSDM dhe koalicionit, partia politike ZNAM, koalicioni VLEN koalicioni Fronti Evropian dhe partia politike Levica. Qëllimi i kësaj analize të programeve të partive politike që të shihet se ne çfarë mënyre partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 i drejtohen popullatës studentore, përmes politikave dhe masave të përfshira në programet e tyre.

Programi i partisë politike të VMRO DPMNE dhe koalicionit të saj është më i shtrirë në masat e planifikuara për studentët. Në thelb, disa nga masat kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe përfitues të drejtpërdrejtë janë

institucionet e arsimit të lartë, disa realizohen përmes institucioneve shtetërore ndërsa disa nga masat që kanë element financiar janë të drejtuar drejtpërdrejt ndaj studentëve. Ndër masat që drejtohen drejtpërsëdrejti ndaj studentëve, mund të veçohen këto masa: bursa studentore (50 milionë euro për bursa studentore dhe të shkollave të mesme), modernizimi i konvikteve studentore, vendosja e programit intern.mk për praktikë në ministri të caktuara (MPJ), punësimi i studentëve më të mirë në institucione të caktuara të synuara (MPJ, agjencitë e sigurisë), oferta e garantuar e punës për 500 studentët më të mirë nga universitetet publike, përmirësimi i shujtës së studentëve, zvogëlimi i pjesëmarrjeve në programe të caktuara studimore etj. Ndër masat që në vetvete nuk nënkuptojnë transfer të drejtpërdrejtë financiar ndaj studentëve, veçohen këto masa: trajnimi i aftësive të IT-së, krijimi dhe qasja në bazën e të dhënave të

revistave shkencore maqedonase, vendosja e e-bibliotekave, hapja e qendrave të reja të karrierës në kuadër të universitetet shtetërore.

LSDM dhe koalicioni gjithashtu përfshijnë masa që drejtpërsëdrejtë kanë për qëllim financimin e studentëve, siç janë: studimet falas në kuotën shtetërore për të gjithë studentët e regjistruar në Fakultetin e Ndërtimtarisë (të gjitha studimet programore) si dhe për të gjithë studentët e regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës, subvencionet për transport ndër komunal me autobus për studentë, rritje për 40% të bursave studentore për studentë nga fusha e shkencave të bujqësisë, pyjeve dhe veterinarisë në institucionet publike të arsimit të lartë në vlerë prej 18.000 denarë deri në 25.000 denarë për periudhën 9 mujore në vit, duke filluar nga viti 2025, dhe punësim të garantuar për të gjithë studentët e diplomuar, me praktikë të detyrueshme të paguar për studentët e Fakultetit të Turizmit gjatë sezonit veror, punësim të garantuar në ministri dhe komunat për të diplomuarit me çmime të fituara,

njohje ndërkombëtare dhe vendase, praktikë gjatë studimeve të tyre, pjesëmarrje në konferenca, seminare dhe të ngjashme, rritje e sasisë së shujtës së studentëve më së paku 200 denarë, dhe disa nga masat janë të destinuara për studentët përmes institucioneve të arsimit të lartë si: zhvillimi i softuerit „Youth job - E-Youth job“ sipas modelit slloven „Stabiliteti ekonomik dhe pavarësia e të rinjve, duke rritur kuotën e studentëve në institucionet e arsimit të lartë publik, konkretisht, duke dyfishuar kuotat e Fakulteteve të Mjekësisë, Fakulteteve Stomatologjike dhe Fakulteteve Farmaceutike, duke nxitur interesin e studentëve për t'u regjistruar në fakultetet e mësimdhënies etj.

Partia politike ZNAM ka përfshirë një numër të kufizuar masash që drejtuar ndaj studentëve, në radhë të parë të natyrës financiare, përkatësisht: bursa studimi në vlerë prej 500 euro në muaj dhe punësim të garantuar të 200 studentëve më të mirë në institucionet shkencore dhe institucionet e sistemit.

Koalicioni VLEN masat e tij i drejton në programet e studimit të fakulteteve pedagogjike dhe të studentëve që



studiojnë në këto fakultete dhe ngritjen e një këshilli të përbashkët të universiteteve shqiptare. Për më tepër, masat i drejtohen tre universiteteve publike që do të inkurajohen të specializohen në fusha më të gjera, por të ndryshme, kryesisht në shkencat inxhinierisë, shkencat sociale dhe humane, si dhe në mjekësi dhe shërbime sociale.

Programi i koalicionit të Frontit Evropian të udhëhequr nga BDI nuk përmban masa specifike që drejtohen drejtpërsëdrejti ndaj studentëve, por fokusi është në masat e përgjithshme si: rritja e buxhetit për arsimin mbi 4.5% të PBB-së, rritja e buxhetit për shkencën mbi 1.5. % e PBB-së, përmirësimi i cilësisë në arsim dhe testimi ndërkombëtar, digjitalizimi i procesit mësimor etj.

Partia politike Levica në programin e saj përfshin dy lloje masash, konkretisht masa që synojnë përmirësimin e arsimit të lartë përmes universiteteve si: vendosja e E-indeksit, E-libër, sponsorizimi shtetëror i ligave sportive studentore, ofrimi i teksteve cilësore dhe falas, manualët dhe materialet e punës,

zvogëlimi i numrit të universiteteve shtetërore në katër (Shkup - UKIM; Manastir - UKLO, Shtip - UGD dhe Tetovë - DUT), heqja e studimeve të disperzuara në të gjitha fakultetet, vendosja e provimeve pranuese në fakultete, vendosja e lëndëve përkatëse në të gjitha fakultetet, vendosja e shtypshkronjave universitare për shtypjen e literaturës së teksteve universitare falas, në tirazhet mëdha, rritja e fondit të librave përmes përkthimeve të literaturës profesionale, kryesisht në zona gjuhësore *jo -anglisht*, digjitalizimi i të gjitha teksteve universitare, shkrimeve dhe praktikumeve - sipas parimit të „qasje e hapur“ (*E-repozitorium*), e drejta e përsëritjes së provimit, për një mesatareje më të lartë, gjatë gjithë periudhës së studimeve, ndryshon mënyra e dhënies së bursave për studimet pasuniversitare dhe studimet e doktoratës jashtë vendit (cikli i dytë dhe i tretë) - të njëjtat të jepen vetëm për fusha dhe specializime të mangëta që nuk ofrohen në universitetet e vendit ose për kandidatët që janë duke u trajnuar për vendin e punës, me detyrim për t'u

kthyer në vend, hartimi i një sistemi të ri të përfaqësimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë. Grupi tjetër i masave janë masat që synojnë drejtpërdrejtë studentët që mund të kenë edhe natyrë financiare: transport falas, zbritje për studentët gjatë dhënies së provimit për lejen e vozitjes dhe pa pagesë dhënien e testit të lejes së vozitjes për studentët më të mirë të gjeneratës, rritje e shumës e cila paguhet në emër të shujtës të subvencionuar të studenteve, vendosje e kategorive të reja të bursave dhe rritja e atyre ekzistuese, vendosja e kredive studentore pa interes, orari 24 orë i punës së leximorëve në universitete dhe fakultete, furnizim me literaturë bashkëkohore profesionale (në formë të shtypur dhe elektronike), rinovimi i të gjitha konvikteve dhe internatet studentore dhe ndërtimi i të rejave, vendosja e arsimit të lartë

falas, subvencionimi i aktiviteteve minimale sociale dhe kulturore, e drejta për studime pasuniversitare dhe doktoratave me pagesë për studentët me një mesatare të lartë deri në diplomim, punësim i garantuar në sektorin publik për 10 studentët më të mirë nga çdo fakultet, e drejta për praktikë me pagesë për të gjithë studentët në sektorin publik dhe privat, etj.

Analiza e të dhënave të marra nga anketa


Për qëllimet e këtij Raporti, është realizuar anketë në formë elektronike dhe të shtypur me qëllim marrjen e informacioneve në lidhje me perceptimin e studentëve për ekspozimin e tyre ndaj korrupsionit zgjedhor. Anketa është realizuar në periudhën 01.06.2024 deri më 15.7.2024, gjatë së cilës janë marrë 218 përgjigje. Format i anketës është përshtatur me afatin e shkurtër kohor të realizimit të projektit dhe përgjigjet e marra janë të natyrës indikative.

Në pyetjen e parë hyrëse „A keni qenë personalisht të ekspozuar ndaj ndonjë situatë ku ushtrimi i disa të drejtave tuaja në arsimin e lartë kushtëzohet me kërkesë për të votuar për ndonjë parti/kandidatë të caktuar në zgjedhje?, e cila në fakt përpiqet të sigurojë drejtpërdrejt informacione nga popullata studentore për ekspozimin

personal ndaj korrupsionit zgjedhor, gjegjësisht në lidhje të ushtrimit të ndonjë të drejte të studentit për të votuar për ndonjë parti të caktuar politike, 82,6% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë përjetuar përvojë të tillë personale, ndërsa 17,4% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë përjetuar eksperiencë të tillë. Në këtë drejtim, duke i pyetur të anketuarit nëse kanë informacione për shembuj të ekspozimit të tillë nga studentë të tjerë, 23,4% e të anketuarve kanë deklaruar se dinë shembuj të tillë nga mjedisi i tyre i afërt, madje 61,5% kanë deklaruar se kanë dëgjuar për shembuj të tillë nga njerëz të tjerë.


A keni qenë personalisht të ekspozuar ndaj ndonjë situatë ku ushtrimi i disa të drejtave tuaja në arsimin e lartë kushtëzohet me kërkesë për të votuar për ndonjë parti/kandidatë të caktuar në zgjedhje?

218 responses



A keni informacione se ndaj studentëve është bërë presion duke kushtëzuar ushtrimin e ndonjë të drejte në arsimin..... për të votuar për ndonjë parti/kandidatë të caktuar në zgjedhje?

218 responses




Në pyetjen e tretë („Sipas mendimit tuaj, ku mendoni se ekziston rreziku më i madh i korrupsionit zgjedhor që synon studentët?“) e cila tenton të detektojë burimin e korrupsionit zgjedhor, vërehet që sipas pikëpamjeve të të anketuarve, burimi më i madh i korrupsionit të mundshëm

zgjedhor janë strehimi i studentëve dhe konviktet e studentëve me 35.8% të përgjigjeve të të anketuarve, pas vijojnë shujtat e subvencionuara të studentëve (25.7%) dhe bursat shtetërore të studentëve (17.4%).

Sipas jush, ku mendoni se ka rrezik më të madh për korrupsion zgjedhor që synon studentët?

218 responses




- në kuadër të fakultetit përmes vlerësimeve pozitive dhe privilegjeve tjera
- në kuadër të akomodimit të studentëve në konviktet studentore
- përmes bursave studentore
- përmes masave për mbështetje të studentëve siç janë subvencioni studentor....
- tjetër

Përveç kësaj, në pyetjen në vijim („Sipas jush, a ka pasur situata kur disa subvencione financiare dhe privilegje që ju takojnë studentëve (bursat, shujtat e studentëve, etj.) janë shfrytëzuar/ndarë para zgjedhjeve me qëllim për të ndikuar tek studentët?“) 46.3% e të anketuarve janë përgjigjur se ka pasur situata

kur disa subvencione financiare dhe privilegje që ju takojnë studentëve (bursat, shujtat studentore etj.) janë përdorur/ndarë para zgjedhjeve me qëllim të ndikimit tek studentët.

Sipas jush, a ka pasur situata kur disa subvencione financiare dhe privilegje që ju takojnë studentëve (bursat, shujtatzgjedhjeve me qëllim për të ndikuar tek studentët?“)

218 responses




- Po
- Jo

Një përqindje e lartë prej 47,2% janë përgjigjur pozitivisht pyetjes “ A ndikojnë komoditetet dhe privilegjet

e ndryshme që synojnë studentët në vendimin tuaj për cilën parti politike/kandidat të votoni?”.

Sipas mendimit tuaj, a ndikojnë komoditetet dhe privilegjet e ndryshme që synojnë studentët në vendimin tuaj për cilën parti politike/kandidat të votoni?

218 responses




Numri befasues 46.3% i të anketuarve janë përgjigjur se janë ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor

nga përfaqësues të organizatave studentore.

A keni qenë të ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor nga ana e përfaqësuesve të organizatave studentore në fakultetin tuaj?

218 responses




Anketa gjithashtu përmbante edhe disa pyetje që kishin për qëllim të përcaktonin nëse dhe në çfarë mase studentët janë njoftuar me mekanizmat e denoncimit të korrupsionit zgjedhor, cilat janë pritshmëritë e tyre nga procedurat pas rasteve të denoncuar dhe në cilat institucione do të denonconin korrupsionin zgjedhor.

Në pyetjen direkte “A dini ku të denonconi në rast se do të përballeni me korrupsionin zgjedhor?”. 66.1% e të anketuarve nuk dinë se ku të denoncojnë korrupsionin zgjedhor që synojnë studentët.

A e dini ku të denonconi në rast se do të përballeni me korrupsionin zgjedhor?

218 responses




Gjithashtu, përqindje e lartë prej 59.2% e të anketuarve janë shprehur se nuk ka mjaft mekanizma funk-

sional për të mbrojtur studentët nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor.

Sipas Juve, a ka mjaft mekanizma funksional për të mbrojtur studentët nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor?

218 responses




Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të anketuarve, gjegjësisht 50.9%, deklaruan se do të denonconin korrupsionin zgjedhor që synojnë studentët, gjë që është optimiste, duke marrë parasysh

se nga ana tjetër, shumica e të anketuarve mendojnë se nuk ka mekanizma të mjaftueshëm funksional për të mbrojtur studentët.


A do të denonconi në qoftë se ballafaqoheni me rastet e korrupsionit zgjedhor që synojnë studentët?

218 responses




Sipas jush, a ekzistojnë mekanizma të mjaftueshëm funksional për të mbrojtur studentët nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor?

218 responses



A e dini se ku të parashtroni denoncim në rast se do të përballeni me korrupsionin zgjedhor?

218 responses




Në pyetjen „Nëse denonconi, ku do të denonconi?“ , shumica e të anketuarve janë përgjigjur se do të denoncojnë në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (25.8%),

Avokatin e studentëve ose organizatën studentore (21.2%) dhe më pas në partinë e kundërt politike (20.7%).

Nëse denonconi, do të denonconi në:

217 responses



Заклучоци

Bazuar në hulumtimin e realizuar, u përcaktuan konkluzionet e mëposhtme:

- Duke pasur parasysh numrin e madh të studentëve në nivel nacional, mungojnë masa dhe mekanizma të veçanta për mbrojtjen e studentëve nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor.
- As Kodi Zgjedhor dhe as Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (veçanërisht kapitulli i katërt) nuk përmbajnë masa të veçanta për mbrojtjen e studentëve gjatë zgjedhjeve (edhe pse përmbahen rregulla të përgjithshme të veçanta që kufizojnë ndikimin përmes pagesave të ndryshme nga periudha e zgjedhjeve).
- Strategjia nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021-2025 nuk përfshin masa të veçanta që synojnë parandalimin e korrupsionit zgjedhor drejtuar ndaj studentëve.
- Në thelb, partitë politike në programet një pjesë të konsiderueshme i drejtojnë drejt studentëve duke parashikuar disa masa, të cilat një pjesë të konsiderueshme kanë karakter financiar.
- Të dhënat nga anketa treguan disa situata të cilat mund të merren parasysh për të përmirësuar kushtet:
- Sipas të anketuarve, burimi më i madh i korrupsionit të mundshëm zgjedhor është akomodimi i studentëve dhe konviktet e studentëve, mandej vijojnë shujtat e subvencionuara të studentëve dhe bursat shtetërore të studentëve dhe
- Edhe pse shumica e të anketuarve nuk dinë se ku të denoncojnë korrupsionin zgjedhor dhe nuk besojnë se do të veprohet në mënyrë përkatëse, ata prapë do të vendosin të denoncojnë korrupsionin zgjedhor.

Препораки

- Përfshirja e masave, si në volum po ashtu edhe në përmbajtje, të cilët kanë të bëjnë me parandalimin e ekspozimit të studentëve ndaj korrupsionit zgjedhor në strategjinë e ardhshme nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.
- Sqarimi i dispozitave ligjore në Kodin Zgjedhor dhe në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit me masa dhe mekanizma për mbrojtjen e studentëve.
- Vendosja e mekanizmave të kontrollit në konviktet e studentëve gjatë shpërndarjes së akomodimit të studentëve dhe shpërndarjes së shujtave studentore me karakter ad hoc gjatë viteve zgjedhore.
- Zbatimi i aktiviteteve edukative që synojnë njohjen e studentëve me mënyrat e denoncimit të korrupsionit zgjedhor dhe mekanizmat në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të studentëve.
- Përforcimi i kapaciteteve në nivel të institucioneve të arsimit të lartë dhe formave të veprimit të organizuara nga studentët për të mbrojtur studentët nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor

Shtojca 1 – Pyetësi i anketës

1. A keni qenë personalisht të ekspozuar ndaj ndonjë situatë ku ushtrimi i disa të drejtave tuaja në arsimin e lartë kushtëzohet me kërkesë për të votuar për ndonjë parti/kandidatë të caktuar në zgjedhje?
 - Po
 - Jo
2. A keni informacione se ndaj studentëve është bërë presion duke kushtëzuar ushtrimin e ndonjë të drejte në arsimin e lartë për të votuar për ndonjë parti/kandidatë të caktuar në zgjedhje?
 - Po, kam shembuj të tillë nga mjedisi i afërt
 - Kam dëgjuar shembuj të tillë nga persona të tjerë
 - Jo
3. Sipas juve, ku mendoni se ka rrezik më të madh për korrupsion zgjedhor që synojnë studentët?
 - në kuadër të fakultetit përmes vlerësimeve pozitive dhe privilegjeve tjera
 - në kuadër të akomodimit të studentëve në konviktet studentore
 - përmes bursave studentore
 - përmes masave për mbështetje të studentëve siç janë subvencioni studentor....
 - tjetër
4. Sipas juve, a ka pasur situata kur disa subvencione financiare dhe privilegje që ju takojnë studentëve (bursat, shujtat e studentëve dhe ng-jashëm) janë shfrytëzuar/shpërndarë para zgjedhjeve me qëllim për të ndikuar tek studentët?
 - Po
 - Jo

5. Sipas juve, a ndikojnë komoditetet dhe privilegjet e ndryshme që synojnë studentët në vendimin tuaj për cilën parti politike/kandidat të voto-
ni?

- Po
- Jo

6. A keni qenë të ekspozuar ndaj korrupsionit zgjedhor nga ana e përfaqë-
suesve të organizatave studentore në fakultetin tuaj?

- Po
- Jo, por unë njoh shembuj të tillë nga studentë të tjerë
- Jo, dhe nuk kam informacione për shembuj nga studentë të tjerë

7. A e dini se ku të parashtroni denoncim në rast se do të përballeni me
korrupsionin zgjedhor?

- Po
- Jo

8. Sipas juve, a ekzistojnë mekanizma të mjaftueshëm funksional për të
mbrojtur studentët nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor?

- Po
- Jo

9. A do të denonconi në qoftë se ballafaqoheni me rastet e korrupsionit
zgjedhor që synojnë studentët?

- Po
- Jo

10. Nëse denonconi, do të denonconi në:

- Ministrinë kompetente dhe institucionin e arsimit të lartë
- Komisionin Shtetëror Zgjedhor
- Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
- Partinë e kundërt politike
- Organizatën ndërkombëtare dhe/ose ndonjë subjekt tjetër i huaj.

